



Data: 29/07/2019

Ref.: 1367/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Kolegji “Fama” në nivel institucional.
- II. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit Fama për periudhën tri vjeçare 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Menaxhment, MA, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Fama për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Obligohet Kolegji Fama që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar mbi akreditimin e programit të studimit Menaxhment, MA.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji Fama ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programit të studimit të cekur në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën në Kolegjin Fama më datë 05.06.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programit të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Milan Pol, Prof. Dr. Kristiina Tonnisson dhe znj. Delia Gologan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Fama dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji Fama përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Fama plotëson plotësisht një (1) (Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit), substancialisht katër (4) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse), ndërsa pjesërisht gjashtë (6) (Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i Cilësisë; Mësimdhënia dhe të nxënit; Hulumtimi; Burimet dhe hapësirat mësimore; Bashkëpunimi institucional).

Sa i përket kapitullit "Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike" ekipi i ekspertëve ka deklaruar se megjithëse Kolegji ka të zhvilluar Kodin e Etikës, dhe Raporti i Vetvlerësimit thekson se janë paraparë praktika të brendshme të auditimit për të siguruar respektim strikt të përmbajtjes së Kodit të Etikës, komuniteti akademik i Kolegjit nuk ishin në dijeni për procedurat e zbatimit të këtij Kodi. Për më tepër, ekspertët kanë theksuar se nuk ekzistojnë procedura dhe mekanizma të qartë për të verifikuar nëse të gjithë anëtarët e komunitetit akademik respektojnë dispozitat e Kodit në aktivitetet e tyre të përditshme. Kolegji nuk ka softuer kundër plagjiazmit për të identifikuar shkeljet eventuale të studentëve, por mbështetet në zotësinë e stafit për identifikimin e rasteve të tilla dhe në deklaratën e studentëve për këtë qëllim. Kjo praktikë është e pamjaftueshme dhe rekomandohet të zhvillohet një qasje institucionale dhe të zbatohet në vazhdimësi. Jo të gjitha rregulloret janë të publikuara në uebfaqe. Uebfaqja e re nuk ka në dispozicion versionin në gjuhën angleze dhe disa pjesë të uebfaqes në gjuhën shqipe, gjatë kohës së hartimit të këtij raporti, ishin nën rikonstruktim.

Sa i përket kapitullit "Menaxhimi i cilësisë", ekspertët kanë gjetur se burime të mjaftueshme janë vënë në dispozicion për proceset e sigurimit të cilësisë në Kolegj dhe se këto procese janë të përqendruara pothuajse tërësisht në mësimdhënie, e shumë më pak ose fare në hulumtim, administrim, udhëheqje, komunikim me publikun dhe fusha tjera të funksionimit të Kolegjit. Meqë sigurimi i cilësisë është përqendruar kryesisht në mësimdhënie (madje vetëm në disa aspekte të mësimdhënies), nuk mund të thuhet se funksionet e sigurimit të cilësisë në tërë institucionin janë të integruara në planifikim dhe në zhvillim të strategjive që mbulojnë tërë gamën e aktiviteteve të institucionit. Pyetësorët me studentë për cilësinë e mësimdhënies përdorën si burimi kryesorë për hartimin e raportit vjetor që i prezantohet rektorit. Rezultatet e këtyre pyetësorëve nuk bëhen publike por vetëm i prezantohen individualisht mësimdhënësit përkatës. Madje as studentët, të cilët përgjigjen në këta pyetësorë, nuk marrin informata kthyesë në mënyrë sistematike se çfarë hapa ndërmerren në bazë të rezultateve të pyetësorëve. Për të arritur rezultatet e synuara sa i përket sigurimit të cilësisë ekspertët rekomandojnë që Kolegji Fama duhet të ndërtojë procedura për mbledhje periodike të të dhënave relevante për vlerësimin e treguesve të sigurimit të cilësisë, gjë që nuk është dëshmuar se ekziston. Ekipi i ekspertëve po ashtu ka potencuar se

nuk ka gjetur dëshmi të formularëve dhe instrumenteve tjera për mbledhje të informatave nga stafi, nga të diplomuarit dhe nga punëdhënësit e as raporte të publikuara lidhur me gjetjet e instrumenteve të tilla. Përveç kësaj, nuk është dëshmuar një vlerësim i rregullt i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe përveç zyrës për sigurim të cilësisë nuk është përmendur se kolegji ka të themeluar komisionin e cilësisë.

Sa i përket kapitullit “Mësimdhënia dhe të nxënit”, ekipi i ekspertëve ka theksuar se Kolegji ka hartuar dhe miratuar disa politika dhe procedura që janë të zbatueshme për programet akademike. Dhe në njëfarë mase duket se Kolegji monitoron zbatimin e këtyre politikave mirëpo nuk vërehen përpjekje për të bërë dallime mes programeve ose pjesëve të tyre. Jo gjithmonë ka qenë e qartë se si bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë së metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit në raport me rezultatet e të nxënit. Ekspertët kanë vërejtur se deklarativisht qasja me nxënësin në qendër është prioritet për Kolegjin, mirëpo gjatë diskutimeve me stafin mësimdhënës kjo qasje nuk është prezantuar me rëndësinë e njëjtë. Pjesa e mjedisit të të nxënit në disa pjesë nuk tregon qartë nxitjen e motivimit të studentëve, vet-reflektimin dhe angazhimin e tyre në procesin e të nxënit. Sa i përket vlerësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit ekspertët kanë gjetur se të diplomuarit dhe punëdhënësit nuk janë të përfshirë sa duhet.

Sa i përket kapitullit “Hulumtimi” ekspertët ndërkombëtar të akreditimit kanë theksuar se megjithëse hulumtimit i është kushtuar vëmendje e konsideruar në deklaratën e misionit të Kolegjit, në aktivitetet e përditshme hulumtimit duket se i kushtohet më pak rëndësi se mësimdhënies. Ekspertët kanë gjetur se fusha e hulumtimit nuk ka tregues të qartë për caqet e performancës. Për shembull stafit i kërkohet që të publikojë një numër të caktuar të punimeve brenda një kohe të caktuar, mirëpo nevojiten informata më specifike. Megjithëse është e qartë për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik se pritjet janë që të bëjnë aktivitete kërkimore, jo të gjithë anëtarët e stafit kanë publikuar nga një punim në vit për tri vitet e fundit. Përveç kësaj ekspertët kanë vërejtur se nuk ndahen mjete të mjaftueshme nga kolegji për hulumtim dhe burimet e jashtme janë shumë të rralla për këtë qëllim. Nuk janë gjetur dëshmi të lidhjes së hulumtimit me mësimdhënien e as të përfshirjes së studentëve në aktivitete hulumtimi.

Një tjetër kapitull i standardeve për të cilin ekipi i ekspertëve ka gjetur se përmbushet pjesërisht është “Burimet dhe hapësira mësimore”. Ekspertët ndërkombëtar të akreditimit kanë theksuar në raportin e vlerësimit se Kolegji ofron hapësira mësimore në dy kampuse, të cilat duken mjaftë mirë në aspektin financiar mirëpo përmirësime ose investime të konsiderueshme duhet bërë në rastin e bibliotekës. Është vërejtur mungese e literaturës, veçanërisht në fushën e mbështetjes së hulumtimit shkencor. Gjatë vizitës ekspertët kanë vërejtur se Kolegji ofron qasje në disa databaza mirëpo shfrytëzimi i tyre mbetet i ulët si mungesë e promovimit të pamjaftueshëm. Linku në uebfaqen e Kolegjit e cila dërgon tek biblioteka ofron informata shumë të pakta, dhe gjatë vizitës në bibliotekë, siç kanë potencuar ekspertët në raportin e vlerësimit, praktikisht nuk kishte “shenja jete”. Disa prej librave që gjendeshin në bibliotekë nuk ishin të regjistruara, gjë që e bën të vështirë të kuptohet nëse kolegji ka një sistem të besueshëm kundër humbjes së materialeve. Ekspertët kanë theksuar se nuk kanë hasur në dëshmi të infrastrukturës ose materialeve mësimore që i dedikohen studentëve me nevoja të veçanta. Gjithashtu, ekspertët kanë deklaruar në raport se është me rëndësi të përmendet se gjatë vizitës, kampusi që ndodhet në periferi të Prishtinës ishte i zbrazët dhe “pa jetë”. Ishte e pamundur të vërtetohej nëse ditëve të tjera gjendja është ndryshe, mirëpo ndjenja e zbrazësisë mbizotëronte dhe, pashmangshëm, ngre pyetjen nëse/në çfarë mënyre përdoret ky objekt për qëllime edukative. Ekspertët kanë shtuar në këtë

pikë se për shkak të buxhetit të centralizuar është e vështirë të bëhet një vlerësim i burimeve financiare të cilat institucioni ndanë për aktivitete të ndryshme, dhe rrjedhimisht është e pamundur të vlerësohet përshtatshmëria e mjeteve të ndara për blerje, katalogim, pajisje, shërbime etj.


Sa i përket kapitullit “Bashkëpunimi institucional” ekspertët kanë gjetur se numri i anëtarëve të stafit dhe studentëve të Kolegjit Fama që marrin pjesë në skema mobiliteti jashtë vendit është mjaft i vogël, kurse numri i stafit/studentëve të huaj që vijnë në Kolegj në kuadër të mobilitetit është shumë më i vogël. Kolegji ofron përkrahje të kufizuar për mobilitet të stafit e edhe më të kufizuar për mobilitet të studentëve. Ekspertët kanë konstatuar se nevojiten përmirësime të konsiderueshme në fushën e mekanizmave që përkrahin ndërtimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Kolegji Fama ka bashkëpunim të ngushtë me një numër të punëdhënësve, bashkëpunim ky i cili përdoret edhe për organizimin e praktikës (internship) për studentët. Megjithatë këto praktika (internship) nuk janë të dizajnuara si përvoja mësimore pasi që nuk përmbajnë rezultate mësimore si dhe nuk janë të llogaritura me ECTS. Ekspertët kanë konstatuar se, megjithëse disa të diplomuar qëndrojnë afër institucionit dhe ndjekin iniciativat dhe zhvillimet e tij, ato janë më shumë përpjekje individuale dhe mungon një qasje institucionale për krijimin e marrëdhënieve me të diplomuarit dhe punëdhënësit. Punëdhënësit dhe profesionistët lokal nuk janë anëtarë të organeve këshillëdhënëse përkatëse të Kolegjit, dhe kontakti që kolegji mban me të diplomuarit nuk mund të shihet si i rregullt dhe me pjesëmarrje. Duke u bazuar në gjetjen e ekspertëve si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Kolegjit Fama, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit të cekur në dispozitiv të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se programi i studimit i cekur më sipër përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e riakreditimit. Megjithatë, duke pasur parasysh Nenin 15, paragrafin 6, të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011, i cili përcakton se *“Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë nuk arrin të fitojë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me një organizim tjetër të akreditimit jo më vonë se pas një viti”* dhe paragrafin 7 i cili përcakton se *“Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës, bartësi mund të ankohet në organin kompetent konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ”*, Kolegjit Fama i ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj në programet e studimit me akreditim valid për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional, sipas dispozitave të cekura më sipër. Studentët e regjistruar në programet e studimit para marrjes së vendimit për mos riakreditim institucional, vazhdojnë studimet e tyre në përputhje me statutin e institucionit si dhe me dispozitat e tjera në fuqi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Fama;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë